

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
T I R A N Ë

Nr.354 Regj.Themeltar

Dt.31.10.2017

V E N D I M  
“NE EMER TE REPUBLIKES”  
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë  
Gjyqtar Altin Abdiu

asistuar nga sekretare gjyqësore Aurora Cjapi, datë 31.10.2017 përfundoi së shqyrtuari kërkesën penale që u përket,

Ankues: M... C... A...sh.a., adresa: Bulevardi “...”, Rruga “...”Nr. 1, Qendra e Biznesit “...”, Tirane, përfaqesuar e autorizim nga av. Alda Abazi.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori Ervin Karanxha.

Objekti : Kundershtim i vendimit “Per sekuestrimin e dokumentave” i dt. 09.10.2017, lidhur me procedimin penal nr. 5613 te vitit 2017, persa i perket Dosjes Permbarimore nr. 0186-15 Regj.

Baza Ligjore : Neni 212 i K.Pr.Penale.

Në konkluzionet përfundimtare, pala ankuese kerkoi pranimin e kerkeses.  
Prokurori kerkoi rrezimin e kerkeses si te pabazuar ne ligj dhe ne prova.  
Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në teresi.

V E R E N

Pala ankuese ka paraqitur per gjykim kerkesen sipas objektit te evidentuar ne pjesen hyrese te ketij vendimi.

Nga shqyrtimi gjyqesor i kerkeses ankimore e cila eshte ne jurdiksionin dhe kompetencen e kesaj Gjykate, ka rezultuar se:

Pales ankuese M... C... A...sh.a. me adrese Bulevardi "...", Rruga "...Nr. 1, Qendra e Biznesit "...", Tirane, per nevoja te hetimeve paraprake lidhur me procedimin penal nr. 5613 te vitit 2017, i eshte sekuestruar Dosja Permbartimore nr. 0186-15 Regj.

Ne gjykim pala ankuese pretendoi se kjo dosje duhet kthyer per te mos penguar dhe vazhduar proceduren permbartimore.

Prokurori shpjegoi se dosja permbartimore eshte sekuestruar me vendimin e dates 09.10.2017, per nevoja te procedimit penal nr. 5613 te vitit 2017. Kjo dosje eshte çuar per ekspertim ne Institutin e Policise Shkencore prane Drejtorise Vendore te Policise. Ne te tilla kushte kjo dosje nuk mund ti kthehet pales ankuese.

Ne lidhje me kete çeshtje prokurori i paraqiti Gjykatës si prove edhe vendimin per kryerjen e Ekspertimit Grafik Krahasues te dates 23.10.2017.

Ne keto kushte, Gjykata çmon se vendimi i prokurorit i dates 09.10.2017 "Per sekuestrimin e dokumentave" rezulton se eshte kryer konform procedurave ligjore, per nevoja te hetimit ne lidhje me procedimin penal nr. 5613 te vitit 2017.

Persa me siper, Gjykata çmon se kerkesa e paraqitur nga pala ankuese rezulton e pabazuar ne ligj dhe ne prova dhe per rrjedhoje ajo duhet rrezuar.

**PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, ne zbatim te nenit 212 të K.Pr.Penale,

**V E N D O S I**

Rrezimin e kerkeses ankimore nr. 354 Regj. Themeltar dt. 18.10.2017.

Shpenzimet proceduriale siç jane bere.

Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit ne Gjykatën e Apelit Tirane.

U shpall sot ne dt. 31.10.2017.

**S E K R E T A R E**  
**AURORA CJAPI**

**G J Y Q T A R**  
**ALTIN ABDIU**

